

Rishikimi i Strategjisë Kombëtare të Diasporës, nis konsulta publike

Në kuadër të diskutimeve të zhvilluara gjatë Samitit të Dytë të Diasporës lidhur me rishikimin e Strategjisë Kombëtare të Diasporës ekspertiza e Organizatës Ndërkombëtare për Migracionin (IOM) ka propozuar disa ndryshime në Strategjinë Kombëtare të Diasporës. Pjesa më e rëndësishme e ndryshimeve të realizuara me ekspertët e IOM është kostimi i masave të Planit të Veprimit të Strategjisë Kombëtare. Ky projekt nuk përfaqëson konkluzione përfundimtare të institucioneve shtetërore, por është një dokument i hapur i cili do të kalojë në disa faza.

Faza e parë do të jetë periudha për mbledhjen e opinionëve me shkrim nga individë dhe ekspertë të ndryshëm; Faza e dytë do të jetë diskutimi në publik i projekt-dokumentit të Strategjisë Kombëtare të Diasporës; Faza e tretë do të jetë përmbledhja dhe miratimi i Strategjisë Kombëtare. Të tre fazat e mësipërme do të kenë fleksibilitet në funksion të realizimit të një dokumenti sa më të plotë. Projekt Strategjia 2021 – 2025 do të përfundojë zhvillimet më të fundit në politikën për Diasporën shqiptare dhe do të vlerësojë qëllimet e saj për të ardhmen.



Publikohet manuali për mësimdhënien në Diasporë



Tashmë mësuesit shqiptarë në Diasporë kanë në dispozicion një dokument të plotë, Udhëzuesin "Për mësimdhënien në Diasporë". Ky manual i hartuar nga Qendra e Botimeve për Diasporën është një dokument informues i ndryshimeve ligjore, akteve dhe shkresave me rëndësi në mbështetje të mësuesve dhe mësimdhënies në Diasporën shqiptare. Ai synon të paraqesë ecurinë e deritanishme të politikave shtetërore që ndikojnë drejtpërdrejt në përmirësimin e statusit të shkollave shqipe dhe të mësuesve në Diasporë. Ky udhëzues është një tregues i bashkëpunimit midis Shqipërisë dhe Kosovës për miratimin e teksteve të përbashkëta për Diasporën nga Komisioni i Përbashkët ndërshtetëror, në zbatim të Marrëveshjes së Përbashkët mes institucioneve përgjegjëse të dy vendeve.

Qendra e Botimeve për Diasporën në Seminarin me mësuesit e Gjuhës Shqipe



Në Prizren, Kosovë po zhvillohet Seminari XV me Mësuesit Shqiptarë të Gjuhës dhe Kulturës Shqipe në Diasporë, i cili ka si qëllim shkëmbimin e përvojave të mësuesve dhe diskutimin për metodat më të përpunuara të mësimdhënies në Diasporë. Ky është viti i pesëmbëdhjetë i organizimit të këtij eventi kushtuar mësuesve shqiptarë në Diasporë. E pranishme në këtë aktivitet është edhe përfaqësuesja e Ministrisë së Shtetit për Diasporën znj. Mimoza Hysa, drejtuese e Qendrës së Botimeve për Diasporën. Institucioni i Qendrës së Botimeve për Diasporën, në ditët në vijim do të bëjë një prezantim të plotë të vizionit, përkushtimit dhe punës së tij gjër më tani.

Ministri u takua me një grup arkitektësh shqiptar, studiues në Universitetin e Firences

Ministri i Shtetit për Diasporën z. Pandeli Majko takoi sot grupin e arkitektëve nga Diaspora shqiptare, studiues në Departamentin e Arkitekturës të Universitetit të Firences, të cilët janë pjesë e programit "Diaspora Burim për Mbrojtjen dhe Zhvillimin e Qendrave Kulturore më pak të njohura". Gjatë bashkëbisedimit ministri Majko i përgëzoi ata për përfshirjen në këtë program pasi japin një kontribut që po japin në atdhe për njohjen dhe analizimin e pasurive të veçanta kulturore që ka Shqipëria, duke theksuar kështu edhe rëndësinë e investimeve të Diasporës në vendin e origjinës. Gjithashtu ai i njohu ata edhe me politikën shtetërore për Diasporën dhe punën që po bëhet me qëllim mbështetjen e të gjitha komuniteteve shqiptare në botë.

Grupi i arkitektëve shqiptar nga Diaspora kanë si fokus të punës së tyre tre zona atë të Përmetit, të Zvërnecit në Vlorë dhe fshatin Razëm, në Malsinë e Madhe. Pas përfundimit të punës së tyre vlerësuese ata do të hartojnë një udhëzues zhvillimor për këto zona që i do t'i paraqitet autoriteteve vendore dhe atyre qendrore. Programi "Diaspora Burim për Mbrojtjen dhe Zhvillimin e Qendrave Kulturore më pak të njohura" është zbatohet nga Organizata Ndërkombëtare për Migracionin (IOM) në bashkëpunim me Ministrinë e Shtetit për Diasporën.



Këshilli Drejtues i Agjencisë Kombëtare të Diasporës zhvilloi takimin e radhës

Në këtë takim morën pjesë Ministri i Shtetit për Diasporën z. Pandeli Majko dhe anëtarët e këshillit të cilët u njohën me aktivitetet e realizuara nga ky institucion. Drejtoresha ekzekutive e AKD-së znj. Etleva Kondi prezantoi një raport të detajuar mbi aktivitetet e zhvilluara nga ky institucion deri më tani dhe ato që janë planifikuar për t'u realizuar në të ardhmen.



KKD, Visar Tasimi kandidon në zgjedhjet lokale SHBA



Një shqiptar kandidat në zgjedhjet lokale që do të mbahen më 5 nëntor në Amerikë. Visar Tasimi, anëtar i Këshillit Koordinues të Diasporës ka bërë publike kandidaturën e tij për Këshillin Bashkiak në qytetin e Naugatuck në SHBA, ku jetojnë rreth 10 mijë shqiptar.